



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 851/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Nenad Lazić kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Burbuqe Bucaliu nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Ferizaj për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 13.11.2013, mori këtë:

## V E N D I M

**HIDHET** si e pas afatshme ankesat e Burbuqe Bucaliu nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Ferizaj: Anr.851/13, Anr.852/13, Anr.853/13, Anr.854/13, Anr.855/13, Anr.856/13, Anr.857/13, Anr.858/13, Anr.859/13, Anr.860/13, Anr.861/13 dhe Anr.862/13.

### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr.851/13, Anr.852/13, Anr.853/13, Anr.854/13, Anr.855/13, Anr.856/13, Anr.857/13, Anr.858/13, Anr.859/13, Anr.860/13, Anr.861/13, dhe Anr.862/13, me datë 13.11.2013, nga Burbuqe Bucaliu, nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Ferizaj në të cilën pretendohet se është manipuluar votat e saj.

- Sipas ankesës Anr.851/13 të datës 13.11.2013 në vendvotimin me nr.2513D në fshatin Talinoc pretendohet se më është bërë manipulimi me vota brenda subjektit.
- Sipas ankesës Anr.852/13 të datës 13.11.2013 në vendvotimin me nr.2511D në fshatin Sojevë pretendohet se më është bërë manipulimi me vota brenda subjektit.

- Sipas ankesës Anr.853/13 të datës 13.11.2013 në vendvotimin me nr.2507D në fshatin Greme pretendohet se më është bërë manipulimi me votat e mia.
- Sipas ankesës Anr.854/13 të datës 13.11.2013 në vendvotimin me nr.2515D në fshatin Koshare pretendohet se më është bërë manipulim me votat e mia sipas dëshmitareve.
- Sipas ankesës Anr.855/13 të datës 13.11.2013 në vendvotimin me nr.2503X në Ferizaj pretendohet se më është bërë manipulim me votat e mia, sipas bisedave me ata që me kanë votuar.
- Sipas ankesës Anr.856/13 të datës 13.11.2013 në vendvotimin me nr.2503D në Ferizaj pretendohet se më janë manipuluar votat.
- Sipas ankesës Anr.857/13 të datës 13.11.2013 në vendvotimin me nr.2502Y në Ferizaj pretendohet se nuk më janë numëruar votat nga votuesit e mi.
- Sipas ankesës Anr.858/13 të datës 13.11.2013 në vendvotimin me nr.2504D në Ferizaj pretendohet se kam më shumë votat se sa që me janë numëruar.
- Sipas ankesës Anr.859/13 të datës 13.11.2013 në vendvotimin me nr.2502D në Ferizaj pretendohet se më janë manipuluar votat.
- Sipas ankesës Anr.860/13 të datës 13.11.2013 në vendvotimin me nr.2501Y në Ferizaj pretendohet se nuk më janë numëruar votat.
- Sipas ankesës Anr.861/13 të datës 13.11.2013 në vendvotimin me nr.2501X në Ferizaj pretendohet se më janë manipuluar votat brenda subjektit tim politik.
- Sipas ankesës Anr.862/13 të datës 13.11.2013 në vendvotimin me nr.2501D në Ferizaj pretendohet se nuk më janë numëruar votat brenda subjektit tim politik.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesave, gjeti se:

### **Ankesat janë te pas afatshme**

Paneli i PZAP-it në bazë të nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it ka vendosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajtoj si një ankesë për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, konstatoi se ankesat e Burbuqe Bucaliu janë të pas afatshme sepse ankesat nuk janë bërë në afatin e paraparë ligjor 24 orë nga shkelja e supozuar deri më 04.11.2013 ora 19:00 por te njëjtat janë dorëzuar më 13.11.2013 në ora 10:15.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim te nenit 118.1 te LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat te cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 4.2 te Rregullave dhe Procedurave te PZAP-it, ne të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund ti hidh poshtë (si te palejuar, të parregullta apo te pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3.2 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat te cilat janë të pas afatshme apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, vendosi si ne dispozitiv te ketij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 851/2013 më datën 13.11.2013



**Këshillë juridike:** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.